

VENDIM
Nr. 42, datë 22.12.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 37, DATË 20.11.2025, “PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.12.2025, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin nr. 37, datë 20.11.2025, ‘Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.’”

KONSTATOI:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., me shkresën nr. 2370 prot., datë 19.12.2025, me lëndë “Kërkesë për licencim”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., për rinovim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-n nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. me vendimin nr. 37, datë 20.11.2025, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.”, me një afat 2-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier, z. Gentian Alika, zotëron diplomë në Fakultetin e Drejtësisë, viti 2005, në Universitetin e Tiranës.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 “a”, e vendimit të KKRR-së nr. 37, datë 20.11.2025, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Fier sh.a.” ndryshon, si më poshtë:

a) Drejtues Ligjor – z. Gentian Alik.

2. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Fier sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja